




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Afatet e shkurtuara, mundësi për kufizim të konkurrencës



Afatet e shkurtuara, mundësi për kufizim të konkurrencës

Autor: **Agon Hysaj**

Shtator 2021

Kjo analizë e shkurtër është përgatitur nga Demokraci Plus (D+) dhe mbështetur nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Komuna e Skënderajit më 30 nëntor 2020 publikoi tenderin për furnizim me pajisje shëndetësore (një mamograf, një rëntgen dhe një ortopan) për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) me vlerë të parashikuar prej 120,000 euro. Edhe pse u përdor procedura e hapur, në këtë tender oferto vetëm një kompani, KosovaMed Healthcare, me çmim 119,880 euro apo vetëm 120 euro më pak se vlera e parashikuar e tenderit. Dosjen e tenderin e kanë shkarkuar 21 kompani që merren me pajisje mjekësore, e megjithatë asnjëra prej tyre nuk ka dorëzuar ofertë.

Nr.	Përshkrimi	Çmimi
1	Mamograf	53,950
2	Rëntgen	38,750
3	Ortopan	18,300
		119,800 Euro

Tabela 1: Çmimet e produkteve sipas kontratës në mes KosovaMed Healthcare dhe Komunës së Skënderajit

Arsyeja se pse ka ofertuar vetëm një operator ekonomik (OE), mund të kuptohet afatet e shkurtëra të dhëna për të dorëzuar ofertë si dhe për dorëzimin (liferimin) e produkteve dhe disa lëshimeve në kriteret e dosjes së tenderit. AK ka kërkuar një mamograf, një rëntgen dhe një ortopan, të gjitha këto pajisje mjekësore. Specifikat teknike që janë kërkuar për këto produkte janë mjaft të detajuara, mirëpo D+ nuk ka vërejtur që është përmendur diku ndonjë markë tregtare e ndonjë kompanie, përveç për kompjuterin, i cili në bazë të emërtimeve është kërkuar të jetë nga prodhuesi Intel. Ligji për Prokurim Publik lejon që për shkak të pamundësisë që të përshkruhet një produkt, të përmenden markat tregtare me kusht që të lejohen produkte ekuivalente. Në këtë rast në specifikacionin teknik nuk është përmendur fjala ekuivalente.

Edhe pse specifikat teknike janë mjaft të detajuara, dosja e tenderit ka disa mangësi. Së pari Komuna e Skënderajit nuk ka kërkuar që OE të kenë licencë për pajisje mjekësore nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM). Edhe pse KosovaMed Healthcare ka dorëzuar këtë licencë, komuna ka qenë e ekspozuar ndaj rrezikut që kompani të palicencuara të mund të ofertojnë në këtë tender. Sipas Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale, çdo pajisje medicinale para hedhjes në treg duhet të ketë certifikatë nga AKPPM¹.

Mangësi tjetër që ka mundur ta kufizojë konkurrencën është afati për dërgimin (liferimin) e pajisjeve. Komuna ka vendosur si kriter se pajisjet duhet të furnizohen për pesë ditë kalendarike. Ky afat është shumë i shkurtër dhe jo i arsyeshëm, kur merret parasysh që në ditë kalendarike bën pjesë e shtuna dhe e diela që janë ditë pushimi. Për shembull në prill të vitit 2020, kur lufta me pandeminë Covid-19 ishte emergjente, Ministria e Shëndetësisë ka dhënë afat prej pesë ditësh pune. Megjithatë asnjë kompani nuk është ankuar për këtë kriter gjatë fazës së pranimit të ofertave. Por kjo nuk do të thotë që ato janë pajtuar me këtë kriter.

Për më tepër Komuna e Skënderajit gjithashtu ka shkurtuar afatin për dorëzim të ofertave. Afati është shkurtuar nga 20 ditë në 9 ditë. LPP thotë se për tenderë që kanë vlerë të mesme (10,000 deri 125,000 euro) afati mund të shkurtohet nga 20 ditë në 10 ditë. Mirëpo komuna në mënyrë të paligjshme ka shkurtuar edhe më tej afatin me arsyen:

¹ Neni 25. Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2014 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9437>

“Për shkak të situatës së krijuar me COVID-19, duke pasur parasysh menaxhimin e situatës në mënyrë më efektive dhe mundësinë për këto pajisje në QKMF, është paraqitur nevoja për këto pajisje.”

Arsyetimi i komunës për shkurtimin e afatit për ofertim nuk qëndron pasi këto pajisje nuk kanë të bëjnë asgjë në luftën kundër COVID-19. D+ ka gjetur se si autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2020 në emër të luftës ndaj pandemisë kanë bërë shkelje të shumta në procedura të prokurimit e ku më kryesoret janë përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe shkurtimi i afatit për të ofertuar. Shkurtimi i afatit për të ofertuar është i lejuar me ligj, por përdorimi i COVID-19 si arsye për të shkurtuar afatin është i ndaluar. Komuna ka mundur që procedurën ta iniciojë më herët dhe të ju japë mjaftueshëm kohë të gjitha OE për të dorëzuar ofertë.

Një tjetër kërkesë jo e menduar mirë është për trajnimin e stafit teknik dhe mjekësor për përdorimin e pajisjeve. Komuna e Skënderajt nuk ka specifikuar fare se sa orë të trajnimit janë të nevojshme, duke e lënë këtë vetëm në përgjegjësi të KosovaMed Healthcare. Pjesë e paramasës është dashur të jetë edhe numri i orëve dhe i personave që do të trajnohen. Kështu mbetet vetëm në dorë të KosovaMed Healthcare sa i përket numrit të personave që do të trajnohen dhe numrit të orëve për trajnim.

KosovaMed Healthcare për mamograf ka ofruar modelin Genoray MX-600. Në dosje të tenderit është kërkuar që për secilin produkt të ofrohet katalogu. Në ofertë OE ka dorëzuar një katalog njëfaqësh, në të cilin nuk janë të shënuar të gjitha specifikat e pajisjes. Në specifikat teknike është kërkuar që mamografi të ketë “Rangu i mAs te kaloj kufirin e epërm prej 635 mAs me fokus gjere”, mirëpo mamografi i ofruar nga KosovaMed Healthcare, Genoray MX-600, kufirin e epërm e përkrah deri në 600 mAs². Pra kërkesa nuk është plotësuar. Komisioni i vlerësimit siç duket nuk ka krahasuar fare specifikat që i ka kërkuar me ato që i ka pajisja. Këtë nuk ka mundur ta bëjë përmes katalogut të dorëzuar nga KosovaMed Healthcare. Në këtë rast është dashur të kërkojë sqarime nga OE ose të vizitojë uebfaqen e prodhuesit për të krahasuar specifikat teknike.

Për pajisjen rëntgen, KosovaMed Healthcare ka ofertuar me modelin FujiFilm FDR Smart F. Specifikat teknike të pajisjes përputhen me ato që janë kërkuar në dosje të tenderit.

Ndërsa për pajisjen Ortopan, KosovaMed Healthcare ka ofertuar me modelin NewTom GO. Mirëpo broshura e ofruar nuk tregon për specifikat teknike të produktit. Në këtë rast edhe pse NewTom GO i ka të gjitha specifikat që janë kërkuar, këtë komisioni i vlerësimit nuk ka mundur ta dijë përmes broshurës që OE fitues ka dorëzuar.

Gjatë implementimit të kontratës komuna nuk ka respektuar hapat që kërkohen në bazë të Rregullës Financiare 01/2013. Komuna ka pranuar mallin dhe pastaj ka dërguar porosinë te operatori ekonomik, ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta, së pari të bëhet porositja përmes urdhërblërjeve e pastaj të pranohet mallit. Sipas Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 22 thotë që së pari duhet të bëhet kërkesa për blerje, pastaj urdhërblerja, hapi i tretë është raporti i pranimit e në hapin e katërt është pranimi i faturës. Pas pranimit të faturës mund të bëhet pagesa³. Komuna ka pranuar furnizimin më 23 dhjetor 2020, ndërsa ka dërguar urdhërblëren më 6 maj 2021. Në dosje të tenderit është

² Product Data of Mammography MX-600

<https://www.mcmedical.com.co/wp-content/uploads/2018/03/mx600.pdf>

³ Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10203>

kërkuar që OE të dërgojë furnizimin pesë ditë pas pranimit të urdhërbljes. Komuna nuk ka pasur mundësi në këtë mënyrë që të masë afatin e furnizimit pasi furnizimi është bërë para dërgimit të urdhërbljes. Kjo tashmë është një dukuri e zakonshme në shumë aktivitete të prokurimit, ku urdhërblerja lëshohet pasi të kryhet furnizimi.

Edhe pse specifikat teknike të pajisjeve nuk duket që janë përshtatur për ofertues të caktuar, shkurtimi i afatit për të ofertuar dhe koha e shkurtër për të dorëzuar pajisjet ka mundur që të shtyjë operatorët tjerë ekonomik që të mos ofertojnë. Komuna e Skënderajt nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet për të rritur konkurrencën. Megjithatë çmimet e kontratës duket që janë në përputhje me çmimin e tregut dhe çmimin e kontratave të njëjta në autoritete tjera kontraktuese.





USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

